

Mevledin Mustafi, PhD¹

UDC:
343.3/7:316-422

**TRAJTIMI I FENOMENIT KRIMINAL NË SHOQËRINË
MODERNE**

**ТРЕТИРАЊЕТО НА КРИМИНАЛНИОТ ФЕНОМЕН ВО
МОДЕРНОТО ОПШТЕСТВО**

**TREATMENT OF THE CRIME FENOMENOM IN THE
MODERN SOCIETY**

Abstract

Though criminology, like many other scientific disciplines, does not have a general definition, however there are definitions that include the minimum number of interlacing elements in this science. Here we will mention some features that must be taken into account when attempting not only the definition of this science, but also when determining its social and scientific role. Criminology is science, which analyzes and studies certain phenomena in inter-disciplinary, multi-disciplinary and multi-methodological manner. Criminology is also a phenomenological and causative or genetic science, because it studies the forms of presentation of its study object and explores the causes of those phenomena by conveying them with their scientific development. Criminology is not a juridical science, but science on experiences, empirical science, which is served by the results of empirical researches and the achievements of empiricism. With the issue of criminal phenomenology many authors have been involved. It should be noted that in this regard the German and Austrian authors are distinguished. Most of the authors who have dealt with the problem of criminal phenomenology, point out that it is the science of crime event. Thus, these authors prove

¹ University Professor in the Field of Criminal Law and Security.

that criminal phenomenology should concentrate on the study of statics, dynamics and typology of forms of manifestation of crime and delinquent behavior.

In the framework of many ideas and opinions regarding the tasks of criminology, we distinguish two traditional groups, according to which the task of criminology is to discover the causes of the crime phenomenon, and the modern outlook, according to which criminology should be more oriented towards the issue of social response to criminality and contemporary factors of criminal appearances where we have exactly selected in this scientific paper the treatment of the phenomenon of crime and criminality in the modern society.

Keywords: criminology, criminality, organized crime, criminal offenses, deviant phenomena, modern society, criminological discipline, criminalization, decriminalization, penalization, prevention, etc.

1. Kuptimi shkencor mbi fenomenin kriminal

Me çështjen e fenomenologjisë kriminale janë marrë shumë autorë. Duhet theksuar se në këtë drejtim dallohen autorët gjermanë dhe austriakë. Pjesa më e madhe e autorëve që e kanë trajtuar problemin e fenomenologjisë kriminale, theksojnë se ajo është shkencë mbi manifestimin e krimit. Kësisoj, këta autorë vërtetojnë se fenomenologjia kriminale duhet të koncentrohet në studimin e statikës, dinamikës dhe tipologjisë së formave të manifestimit të krimit dhe sjelljeve delikuate. Po ashtu, sipas tyre, ajo duhet të merret edhe me përshkrimin e mënyrës së kryerjes së krimeve të ndryshme, me studimin dhe njohjen e personalitetit të kryerësve respektivisht me studimin e jetës së delikuentëve dhe, në fund, me tipologjinë dhe klasifikimin e kriminelëve.²

Në këtë drejtim, ai mendon se fenomenologjia kriminale duhet posaçërisht të merret me studimin dhe analizën e tipave të kriminelëve të ndryshëm, dhe kriminelet profesional me mënyrën e sjelljes, e posaçërisht me analizën dhe studimin e zhargonit të tyre të veçantë të komunikimit. Roland Grasbergeri, gjithashtu thekson se fenomenologjia kriminale studion morfologjinë e krimit, gjegjësisht manifestimin e tij në botën e jashtme. Po ashtu, edhe autori i njohur francez Zhan Pinatel-i, thekson se fenomenologjia kriminale është degë e

² Bashkim Dr. Selmani „Kriminologjia dhe penologjia”-Kolegji “Fama”-Prishtinë, 2013.

kriminologjisë e cila merret me studimin e formave të jashtme të sjelljeve kriminale dhe mënyrën e jetës së delikuentëve.

Kriminaliteti, si dukuri mjaft komplekse, paraqet një fenomen që kërkon një angazhim të veçantë në hulumtimin dhe studimin e tij. Në këtë drejtim, veçmas shtrohet nevoja e studimit dhe analizës së vëllimit të tij në një shoqëri. Me vëllim, si dihet, nënkuptojmë aspektin kuantitativ të përhapjes dhe pranisë së krimit në shoqëri të ndryshme. Po ashtu, në trajtimin dhe studimin e kriminatetit është e domosdoshme të studiohet dhe ndriçohet dinamika e lëvizjes së kriminalitetit në periudha kohore dhe në vende të ndryshme. Prandaj, si detyrë e veçantë e fenomenologjisë kriminale është edhe njohja me dinamikën e përhapjes dhe shtrirjes së kriminalitetit në një vend të caktuar. Në kuadër të trajtimeve fenomenologjike, vend të veçantë zënë edhe analiza dhe studimi i strukturës dhe ndryshimeve strukturale të kriminalitetit dhe sjelljeve delikuede në një shoqëri. Në këtë drejtim posaçërisht kujdes i veçantë i kushtohet edhe analizës dhe studimit të personalitetit të delikuentit, përkatësisht analizës dhe trajtimit të vetive individuale dhe personale të kryerësve të veprave të ndryshme penale.³

2. Fenomeni bashkëkohor kriminal dhe pasojat nga kriminaliteti në shoqërinë bashkëkohore

Shikuar në këtë prizëm, fenomenin bashkëkohor kriminal dhe pasojat nga kriminaliteti në shoqërinë bashkëkohore, pikërisht, sot ekziston një numër i madh kriminologësh të cilët e parashtrojnë këtë pyetje në një mënyrë më ndryshe si për nga objekti i studimit ashtu edhe për nga metodat e veprimit. Në të vërtetë, sot, kur gara për pasuri material paraqet qëllimin themelor të të psikologjis së individit apo funksionimit të përditshëm, jo vetëm të shumicës së individëve, por edhe të organizatave, e madje edhe shteteve, me ç'rast masa, struktura dhe dinamika e kriminalitetit shënon vlera të papara ndonjëherë, gjithnjë e më aktual bëhet parashtrimi i kësaj pyetjeje në mënyrën e veprimit kriminale dhe për matjen e pasojave në shoqërinë bashkëkohore, prandaj në këtë grafikun e kemi paraqitur strukturën e definimit të kriminalitetit si dukuri negative në shoqëri e cila vështrohet në këtë pikëpamje shkencore si:



Fig. Nr. 1 Paraqitja e krimit si dukuri negative

Sipas një përkufizimi, kriminaliteti paraqet grupin e të gjitha veprimeve që e rrezikojnë ose dëmtojnë vlerat themelore të njeriut të mbrojtura me ligj. Ato vlera themelore mund të jenë individuale jeta e njeriut, integriteti fizik apo trupor, liria, pasuria, siguria etj., apo kolektive, vlerat e përbashkëta rregullimi shoqëror, siguria e shtetit, institucioni, sistemi ekonomik apo shoqëror i shtetit, etj. Ndonëse kriminologjia, si shumë disiplina tjera shkencore, nuk e ka një përkufizim të përgjithshëm, megjithatë ekzistojnë përkufizime që përfshijnë numrin minimal të elementeve të cilat gërshetohen në këtë shkencë.⁴

3. Struktura e kriminalitetit

Kur bëhet fjalë për vëllimin, dinamikën, tipat, llojet dhe format e kriminalitetit në një vend, zakonisht, si tregues të këtyre karakteristike shërbejnë statistikatat kriminale, qofshin ato kombëtare apo ndërkombëtare. Lidhur me saktësinë dhe rolin e këtyre shënimeve statistike, është folur më herët, por në kuadër të trajtimeve të vëllimit të kriminalitetit tani do të parashtrihen disa të dhëna dhe shënime mbi praninë e krimit në disa shtete. Sipas të dhënave të institucioneve dhe shërbimeve amerikane që merren me përcjelljen dhe regjistrimin e krimeve të kryera në SHBA, si p.sh. “Uniform Crime Reportes”-UCR, të cilin e udhëheqin se bashku Ministria e Drejtësisë dhe Byroja

⁴ Fenomenologjia kriminale është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit, me strukturën dhe dinamikën e tij.

Federale e Hetimeve-FBI, mbi shpeshinë dhe llojet e krimeve të paraqitura si: vrasjet, atakimet e rënda kundër personalitetit, dhunimet, vjedhjet e rënda, vjedhjet e automjeteve që ndodhin brenda një viti.

Për shembull gjatë vitit 1993, në SHBA për çdo dy sekonda është kryer një atakim kundërligjor. Nëse shikohet struktura e krimeve të kryera gjatë këtij viti del se 54,8% janë vjedhje, 20,6% janë vjedhje të rënda, 11,1% janë dhunime seksuale, 7,8% janë lëndime të rënda trupore, 4,7% janë grabitje dhe 0,2% janë vrasje. Për paraqitjen e vëllimit dhe strukturës së krimeve në SHBA, janë mjaft të çmuara edhe të ashtuquajturat pasqyra nacionale të viktimave të kriminimit- "National Crime Victimization Survey" - NCVS, të cilat botohen një herë në tri vjet. Sipas këtyre pasqyrave, bëhet kërkimi në bazë të modelit të 49 mijë familjeve dhe anëtarëve më të vjetër se 12 vjet, të cilët merren në pyetje lidhur me faktin nëse kanë qenë viktimë e ndonjë krimi (dhe çfarë krimi) gjatë vitit të shkuar.

Sipas këtyre pasqyrave del se gjatë vitit 1991, më se 12,1 % të popullsisë së shteteve perëndimore të SHBA-së, kanë qenë viktimë e ndonjë krimi, ndërsa 9,1% të banorëve të shteteve të Lindjes, të SHBA-së, sikur edhe 9% të banorëve të shteteve të Jugut të SHBA-së.

Sipas statistikave ndërkombëtare kriminale, shtetet me shkallë të vogël të pranisë së kriminalitetit janë: Zvicra, Suedia, Japonia, Irlanda, Austria etj. Të dhënat statistikore kriminale mbi ecurinë e kriminimit nëpër vendet e ndryshme të botës, tregojnë se numri më i madh i krimeve u përket krimeve kundër pronës, krimeve të dhunës, krimeve kundër sigurisë në trafik ose në komunikacion, krimeve kundër personit etj. Në vijim do të paraqesim disa të dhëna mbi procedurën e ndjekjes penale gjegjësisht lëndë të autoriteteve të prokurorisë në disa vende evropiane mbi numrin e lëndëve të trajtuara në 100,000 banorë.⁵

4. Disa veçori themelore të fenomenit kriminal

Kriminaliteti në periudhat e ndryshme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, është manifestuar në forma të ndryshme. Sjelljet kriminale dhe format e kriminalitetit gjatë historisë njerëzore, mbajnë të gjitha karakteristikat themelore të vetë shoqërisë, vete sistemit ekonomik, politik dhe juridik të saj. Në trajtimin e formave të kriminalitetit kanë ushtruar ndikim themelor, vlerat dhe normat e kohës dhe vendit ku ato forma dhe sjellje kriminale janë paraqitur. Në këtë mënyrë mund të

⁵ L. Glick vepra e cituar f. 36-40; Joseph Shetey etj. vep. e cit. f. 56-57, 60-64, 65-70.

flitet për disa sjellje delikvente e devijuese në shoqëritë primitive, për kriminalitetin në shoqëri skllavopronare dhe për format e kriminalitetit në shoqëritë bashkëkohore.

Në këto shoqëri apo formacione shoqërore-ekonomike, si sjellje kriminale, janë trajtuar dhe me ligj janë përcaktuar të gjitha ato veprime të cilat kanë cenuar dhe rrezikuar të mirat e qytetarëve dhe veçmas interesat e qarqeve në pushtet. Mirëpo, me siguri, nëse përcillet me kujdes zhvillimi i inkriminimeve të sjelljeve të ndryshme shoqërore si sjellje kriminale do të vërehet një përpjekje që disa të mira dhe vlera themelore, natyrore, universale të mbrohen dhe cenimi i tyre të trajtohet si vepër penale gjegjësisht si krim, gati në të gjitha sistemet shoqërore ekonomike. Në këtë kontekst, mund të përmendet mbrojtja e jetës dhe trupit, mbrojtja e pronës, mbrojtja e nderit etj., ku gati në të gjitha sistemet shoqërore ekonomike, cenimi dhe rrezikimi i tyre është trajtuar si krim, si vepër penale.

Nga ana tjetër, gjithashtu duke e shikuar zhvillimin e tillë historike, vërehet se secili fondacion shoqëro-ekonomik, lidhur me këtë problematikë, ka pas disa veçori të vetat dhe është cilësuar me forma dhe strukturë të veçantë të kriminalitetit që nuk ka qenë karakteristike për shoqëritë dhe formacionet tjera të mëvonshme. Paraqitja e kriminalitetit si dukuri shoqërore e ka rrugën e vetë historike, e cila në formacionet e ndryshme shoqëro-ekonomike ka pasur specifika dhe karakteristika të veçanta. Në këtë drejtim, më të drejtë, në literaturën kriminologjike, theksohet se vëllimi dhe format e krimeve dhe sjelljeve kriminale, kanë qenë të lidhura ngushtë me zhvillimin dhe transformimin e shoqërive dhe sistemeve të caktuara shoqërore ekonomike. Ky proces i varshmërisë së formave të kriminalitetit nga transformimet shoqërore veçmas vërehet në shoqëritë bashkëkohore, ku brenda afateve të shkurtra kohore në vendet e ndryshme, ose në të njëjtin vend, vërehen forma dhe lloje të reja të manifestimeve kriminale.

5. Mobiliteti shoqëror dhe kriminaliteti

Ndryshimet e tilla të hovshme, lëvizja e madhe e cila ndodh sot në botën bashkëkohore. drejtpërsëdrejti ndikon edhe në paraqitjen e formave të ndryshme të kriminalitetit. Në literaturën kriminologjike, këto lëvizje dhe ndryshime, shpeshherë emërtohen me termin mobilitet shoqëror. Ky mobilitet ka të bëjë me ndryshimet në shoqëri, si në aspektin horizontal gjithashtu edhe aspektin vertikal. Zhvillimi i hovshëm ekonomik, industrializimi, urbanizimi, rritja dhe zgjerimi i rrjetit

të komunikacionit, përsosja e mjeteve të komunikimit publik, aplikimi i teknologjisë elektronike dhe kompjuterike, kanë nxitur sot transformime të mëdha, të cilat reflektohen edhe në format e paraqitjes së sjelljeve kriminale.

Këto transformime, posaçërisht kanë të bëjë me paraqitjen e teknikave, mjeteve, mënyrave më të reja të kryerjes së sjelljeve kriminale e nga ana tjetër gjithashtu edhe me përsosjen e shërbimeve të policisë dhe organeve të tjera të cilat merren me zbulimin, ndjekjen dhe parandalimin e tyre në shoqëritë bashkëkohore. Është mirëfilli e ditur se sot në shume vende flitet për praninë e krimit të organizuar, për terrorizmin, për dukurinë e narkomanisë, për kriminalitetin në ekonomi, për lëvizjen e madhe të grupeve dhe shoqatave kriminale prej një vendi në vendi tjetër prej një shteti në shtetin tjetër dhe pasojat e rënda dhe të rrezikshme të cilat paraqiten në këtë drejtim.⁶

6. Veçoritë kohore dhe sezonale të kriminalitetit

Kriminaliteti si dukuri komplekse shoqërore, shpreh edhe disa veçori dhe karakteristika kohore dhe regjionale. Shumë autorë në këtë drejtim kane hulumtuar dhe vërtetuar në kërkimet e tyre empirike se kriminaliteti dallohet prej kohës në kohë, vërehen karakteristika të veçanta të kriminalitetit gjatë natës, ditës, gjatë sezonit, prej një regjioni në regjionin tjetër etj., ndonëse disa forma të kriminalitetit janë bërë gati universale për të gjitha regjionet e botës. Kjo veçmas ka të bëjë me kriminalitetin e organizuar dhe profesional, i cili dikur ishte karakteristik vetëm për shtetet e zhvilluara dhe për qytete të mëdha industriale si p.sh. SHBA, Francë, Japoni etj. Ndërsa, sot, këto forma të kriminalitetit janë të pranishme edhe në disa vende të tjera të cilat janë në zhvillim apo të pazhvilluara p.sh. në Indi, në Afrikë, në Amerikën Latine dhe në vise të tjera. Disa hulumtime kriminologjike në SHBA lidhur me karakteristikat kohore të kriminalitetit kanë vërtetuar se disa forma të kriminalitetit paraqiten gjatë ditës, ndërsa tjerat gjatë natës, ndërsa shikuar sipas orës, frekuenca e tyre është shumë e theksuar gjatë sekondave, minutave dhe orëve. Krimi dhe lëvizja e tij tregon edhe disa veçori për sa i përket paraqitjes gjatë natës dhe gjatë ditës.

⁶ Autori i njohur Hans Gros, mendon se fenomenologjia kriminale duhet të merret me studimin e simptomave të jashtme të kriminalitetit. Mendimtari tjetër Ernest Selig, mendon se fenomenologjia kriminale nënkupton përshkrimin e formave speciale të kryerjes së krimeve të ndryshme, p.sh. teknikën e kryerjes së vjedhjeve me thyerje, mënyrën e falsifikimit, studimin e vetive dhe gjesteve të ndryshme të delikuentëve etj.

Kështu, konstatohet se krimet e rënda kundër pasurisë, si vjedhjet, plaçkitjet, grabitjet, kryhen më tepër gjatë natës. Po ashtu, në literaturën kriminologjike flitet për karakteristikat e veçanta që tregojnë lëvizja e kriminalitetit gjatë muajve dhe sezoneve të caktuara, sipas konstatimeve të kriminologut amerikan Leonard Glick, të cilat i bazon në Uniform Crime Reports, del se në SHBA frekuenca më e madhe e krimeve shprehet gjatë muajit gusht, ndërsa më e vogla, gjatë muajit shkurt. Sipas të njëjtave konstatime, krimet kundër pasurisë, e sidomos vjedhjet dhe plaçkitjet, janë në rritje gjatë muajit gusht, ndërsa më pak paraqiten gjatë muajit shkurt. Po ashtu, sipas të dhënave statistikore kriminale, vërehen lëvizje të ndryshme të pranisë së krimit gjatë sezonit të dimrit dhe të verës. Kështu, në SHBA, gjatë muajve të verës vërehet rritje e dukshme e krimeve të dhunës, ndërsa gjatë muajve të dimrit këto krime janë më të ulëta.⁷

7. Veçoritë regjionale të kriminalitetit

Në literaturën kriminologjike, ekzistojnë disa mendime për të ashtuquajturat regjione të veçanta kriminale, në të cilat kriminaliteti është më tepër i shprehur. Kështu, flitet për faktin se kriminaliteti i dhunës, prostitucioni, narkomania, bixhozi dhe duhani të tjera të ngjashme janë më tepër të koncentruara në regjionet industriale, në qendrat e mëdha, në metropole botërore, ku grumbullimi dhe mobiliteti i popullsisë është më i madh. E nga ana tjetër, në disa regjione, janë më të shprehura, p.sh., krimet kundër jetës dhe trupit, ndërsa në regjionet kufitare sidomos pranë porteve detare, vijave kufitare etj., janë të pranishëm dukuritë e tregtisë dhe kontrabandës me artikuj të ndaluar, ose tregtia me valutë të huaj. Krimet e dhunës sipas kërkimeve kriminologjike të bëra në disa vende, janë regjistruar më tepër në qytete dhe qendra të mëdha urbane dhe industriale. Sipas një studimi në SHBA mbi krimet e dhunës, në qytete të mëdha janë regjistruar 999 raste në 100.000 banorë, në viset suburbane 476 raste në 100.000 banorë, në viset rurale dhe fshatare 226 raste në 100.000 banorë etj. Krimet kundër pasurisë në qendra të mëdha 5401 raste në 100.000 banorë, në qendra më të vogla 4830 raste në 100.000 banorë dhe në viset rurale 1805 raste në 100.000 banorë. Në këtë drejtim, shpeshherë në literaturën kriminologjike përdoret termi “Zona kriminale” përmes të cilit dëshirohet të theksohen disa regjione ku kriminaliteti është më tepër i

⁷ Kriminologjia është shkencë e cila analizës dhe studimit të dukurive të caktuara iu qaset në mënyrë inter-disciplinare, multi-disciplinare dhe multi-metodologjike.

pranishëm se sa në regjionet tjera. Për këtë arsye, ka mendime se do të duhej të konstituohej një disiplinë e veçantë kriminologjike e cila do të merrej kryekëput me studimin e shpërndarjes regjionale të kriminalitetit dhe ajo do të quhej Gjeografi Kriminale.

8. Prania e kriminalitetit në relacionin fshat-qytet

Në trajtimet e fenomenit të kriminalitetit dhe manifestimeve të tij, me interes të veçantë janë kërkimet dhe studimet e shpërndarjes së kriminalitetit në relacionin fshat qytet, vise rurale apo vise urbane. Kërkimet e shumta, që janë bërë në këtë drejtim, vërtetojnë se paraqitja e kriminalitetit dhe shpërndarja e tij në regjionet fshatare, dallon nga paraqitja dhe shpërndarja e tij në regjionet e qyteteve, qendrave lëndryshme industriale. Këto dallime kanë të bëjnë si për nga format e vëllimi i paraqitjes, ashtu edhe për nga shkaqet dhe pasojat e sjelljeve të tilla kriminale. Kësisoj, delikuenca e të miturve, prostitucioni, narkomania, kriminaliteti i dhunës, është shumë më i përhapur në qendrat urbane dhe industriale sesa në qendrat fshatare e rurale. Kjo për arsye se në këtë drejtim ndikojnë disa faktorë, për shembull zakonisht fshati është regjion në të cilin jeta është më pak dinamike. Aty ekziston një raport më i theksuar i lidhjeve në mes njerëzve dhe banorëve dhe një solidaritet më i madh në mes tyre. Banorët e fshatit njihen në mes veti. Për këtë arsye në këto vise vlejnë disa norma dhe vlera tjera morale dhe konsiderata që në një mënyrë pengojnë paraqitjen e disa sjelljeve kriminale. Ndërsa, në ambientin e qytetit, qendrës industriale, vërehet përherë në lëvizje e madhe, një mobilitet i madh, një atmosferë e një vrapi të banorëve të qyteteve për profit.

Në qytet mbretëron një dendësi e madhe e popullsisë; njerëzit shumë më pak janë të lidhur në mënyrë tradicionale në mes veti. Jeta është shumë më anonime dhe e atomizuar. Në qendrat industriale dhe në qytete, vlejnë disa norma dhe standarde të tjera morale. Në këto mjedise dominon psikologjia individualiste dhe njerëzit janë në pjesën më të madhe të preokupuar për arritjen e fitimeve dhe realizimin e interesave të caktuara që nuk përputhen shpesh me mundësitë materiale dhe me norma të ndryshme etike dhe ligjore. Në qendrat urbane dhe në qytete, veçmas kanë ndikim të madh mjetet e informimit dhe komunikimit publik, të ashtuquajturat “masmedia”, të cilat shpeshherë me shkrimet dhe mënyrën e paraqitjes nxisin te qytetarët dhe individët e ndryshëm kërkesa, instinkte dhe dëshira që nuk përkojnë shpesh me mundësitë reale të tyre. Vetë këto rrethana ndikojnë që nëpër qendra

urbane dhe industriale, kriminaliteti dhe format e tij të jenë me të shprehura se sa në qendrat fshatare.⁸

9. Moshë, gjinia dhe kriminaliteti

Moshë është gjithashtu karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal. Të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore si dhe nga shënimet e kërkimeve empirike kriminologjike, flasin se me veprimet dhe sjellje kriminale merren persona të moshave të ndryshme. Mirëpo edhe në këtë drejtim vërehen disa ligjshmëri dhe kategori të moshave të cilat marrin më tepër pjesë në kryerjen e sjelljeve të ndryshme kriminale. Siç dihet, moshë e kryerësve të veprave penale, përkatësisht sjelljeve kriminale, mund të ndahet sipas përcaktimeve ligjore pozitive penale, ndahet në moshë të personave të mitur dhe personave të rritur⁶. Mirëpo, brenda këtyre dy ndarjeve kryesore, kemi edhe ndarje të tjera. Moshë e mitur ndahet në të rritur të rinj, e cila përfshin moshën prej 14-16 vjet dhe në të mitur të rritur që përfshin moshën prej 16-18 vjet. Kategoria e personave deri në moshën 14-vjeçare, në literaturën kriminologjike dhe juridiko penale trajtohet si moshë e fëmijëve dhe zakonisht personat e kësaj moshe nuk i nënshtrohen trajtimeve juridiko-penale. Këta persona, siç dihet, nuk janë të përgjegjshëm nga aspekti juridiko-penal. Ndaj tyre, nëse kryejnë veprimet delikvente, zakonisht ndërmerren masa të kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ana e familjes dhe organeve të ndryshme të cilat merren me mbrojtjen e fëmijëve dhe me kujdes social. Mirëpo, në disa shtete, në këtë drejtim bëhen edhe përjashtime. Shpeshherë, në disa shtete të Lindjes, moshë e personave prej 10-14 vjet i nënshtrohet përgjegjësisë së caktuar penale.

Si moshë e rritur konsiderohet moshë prej 18 e deri në vdekje të individit. Mirëpo pjesëmarrja në kriminalitet e kësaj moshe, pra moshës së rritur, nuk është njësoj në të gjitha fazat e jetës së këtyre individëve. Në literaturën kriminologjike dhe në kërkimet praktike, ndarja dhe kategorizimi i moshave të personave të rritur zakonisht bëhet në dekada, p.sh. ndahen në faza prej 10 apo 20 vjetësh, apo edhe më pak. Kësisoj flitet për moshën e personave të rritur prej 18-25 vjet si moshë e veçantë, pastaj moshë prej 25-30, moshë 30-40 vjet, moshë 40-50, moshë 50-60 dhe, në fund, moshë më e vjetër se 60 vjet. Nëse shikohen të dhënat

⁸ Kriminologjia gjithashtu është shkencë edhe fenomenologjike edhe kauzale ose gjenetike, sepse studion format e paraqitjes së objektit të saj të studimit dhe hulumton shkaqet e atyre dukurive duke i përcjellë ato me zhvillimin e vet.

statistikore, gjyqësore dhe të dhënat nga kërkimet empirike kriminologjike në botë, vërehet se moshat më prezente në veprimet kriminale janë moshat prej 25-30, pastaj grupi i moshës 30-50 dhe më pak grupi i moshës mbi 60 vjet. Vlen të theksohet se edhe mosha prej 18-25 është mjaft prezente dhe kjo vlerësohet si një i ashtuquajtur kriminaliteti i të rinjve i cili në botën bashkëkohore tregon karakteristika të veçanta, si për nga mënyra e kryerjes, ashtu edhe për kah intensiteti i paraqitjes në veprimet kriminale. Nga literatura kriminologjike dhe të dhënat nga praktika gjyqësore, del se grupet e tilla të moshave të kryerësve të veprave penale, pak a shumë janë të njëjta në të gjitha vendet e botës me oscilime shumë të vogla, prej një regjioni në regjionin tjetër, e sidomos prej brezave të ndryshme klimatike në brezat tjerë. Në këtë drejtim, theksohet se në brezat e nxehtë klimatike dhe shtetet të cilat gjenden në ato breza, vërehet një pjesëmarrje më e madhe e grupeve të moshave më të reja, ngase si thuhet atje, për arsye klimatike dhe biologjike, arrihet më herët pjekuria biofizike dhe biopsikike e popullatës së ve.

Nga ana tjetër, në vendet Skandinave dhe në viset me klimë me të ftohtë, pjekuria biopsikike dhe biofizike vjen më vonë, kështu që pjesëmarrja e moshave, shikuar sipas viteve të kryerësve të veprave penale, është më e vonshme në këto regjione. Pjesëmarrja e moshave të caktuara dallon edhe në kyçjen e tyre në kryerjen e krimeve të ndryshme. Kësisoj mosha e re merr pjesë më shumë në kryerjen e krimeve kundër pasurisë si janë vjedhjet, vjedhjet me thyerje, plaçkitjet, trafiket ilegale me narkotik etj. ndërsa të rriturit në krimet tjera duke filluar prej krimeve kundër jetës dhe trupit, dhunimet, krimi i organizuar etj. Grupi i moshave 25-30 dhe 30-50, është grupi i popullatës më aktive në jetën e përditshme në çdo shoqëri. Këto grupe të moshave, më së shpeshti ballafaqohen me probleme të llojllojshme të jetës së përditshme. Për këtë arsye, edhe ata vijnë në situatë që më së shpeshti kryejnë sjellje kriminale dhe të shkaktojnë konflikte të caktuara, të cilat sjellin kriminalitetin në shoqëri. Gjinia ose përkatësia seksuale, në pjesëmarrjen e kriminalitetit, gjithashtu vështrohet në literaturën kriminologjike dhe interpretohet nga këndvështrime të ndryshme. Ekziston një përshtypje e përgjithshme, në bazë të të dhënave të statistikës kriminale dhe praktikës gjyqësore, se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkullore. Sipas kërkimeve kriminologjike të bëra në shumë vende të botës në SHB A, Gjermani, Francë, Angli, Japoni, dhe vende tjera, deri në kohën më të re, gjinia mashkullore, përkatësisht kryerësit e veprave kriminale të gjinisë mashkullore, kanë

dominuar në mënyrë absolute. Mirëpo tani, në shoqërinë bashkëkohore, gjendja ka ndryshuar dukshëm ngase edhe femrat, gjithnjë e më tepër, po marrin pjesë në kryerjen e sjelljeve të llojllojshme kriminale.

Gjatë vitit 2003 sipas shënimeve statistikore të gjykatave komunale të Kosovës mbi kryerësit e veprave penale sipas gjinisë dhe llojit të disa veprave penale dhe se 95% të këtyre veprave i kryejnë personat gjinisë mashkullore, e vetëm 5% të gjinisë femërore.

Sipas disa të dhënave statistikore, nga literatura kriminologjike, në vendet e ndryshme, përqindja e pjesëmarrjes në kriminalitet të përgjithshëm e personave të gjinisë femërore, sillet nga 8-10% të gjithë pjesëmarrësve. Mirëpo, duhet theksuar se te disa sjellje kriminale dhe vepra penale pjesëmarrja e femrës është më e madhe. Ndaj, sipas disa konstatimeve, në literaturë dhe në bazë të shënimeve statistikore kriminale, vërehet se femrat marrin pjesë në kryerjen e krimeve kundër nderit dhe dinjitetit njerëzor, kundër jetës dhe trupit, kundër pronës dhe veçmas janë të shprehura në aktivitetet kriminale që kanë të bëjnë me prostitucionin etj.⁹

10. Karakteristika e kriminalitetit të femrave

Karakteristika e kriminalitetit të femrave është edhe fakti se ato më tepër marrin pjesë në kryerjen e krimeve si ndihmëse, shtytëse e më pak si kryerëse e drejtpërdrejtë apo organizatore të krimeve të caktuara. Pjesëmarrjen e vogël të femrave në kriminalitet, disa autorë janë të prirë ta shpjegojnë dhe ta arsyetojnë me faktin se femra është një qenie biopsikike dhe biofizike më e ndjeshme, më e dobët në pikëpamje anatomiko-fizike etj.

Në këtë drejtim, veçmas theksojnë vetitë personale anatomiko-psikike si për shembull, emocionalitetin e theksuar, ciklin menstrual, shtatzëninë, lindjet, klimakteriumin të cilat ndikojnë që ajo në raste të caktuara të jetë më agresive, të ketë sulme dhe paraqitje hysterike, të bie në depresione dhe gjendje të tjera psikike të cilat objektivisht mund ta shtyjnë dhe ta nxisin në veprime dhe sjellje kriminale.

⁹ Në të vërtetë, sot, kur gara për pasuri material paraqet qëllimin themelor të psikologjisë së individit apo funksionimit të përditshëm, jo vetëm të shumicës së individëve, por edhe të organizatave, e madje edhe shteteve, me ç'rast masa, struktura dhe dinamika e kriminalitetit shënon vlera të papara ndonjëherë, gjithnjë e më aktual bëhet parashtrimi i kësaj pyetjeje në mënyrën e veprimit kriminale dhe për matjen e pasojave në shoqërinë bashkëkohore.

Disa autorë, mendojnë se disa sjellje kriminale janë tipike femërore. Në këtë drejtim flitet për krimin e vrasjes së të porsalindurit, pjesëmarrjen në prostitucion, mashtrimet dhe krimet tjera. Disa të tjerë theksojnë mënyrat dhe metodën e veçantë të kryerjes së krimeve nga personat e gjinisë femërore. Kësisoj, flitet për aftësinë e femrës që ta vejë në lajthim viktimën, për shfrytëzimin e vetive të saj fizike, për dinakërinë dhe për përdorimin e disa mjeteve të veçanta të kryerjes së veprave penale etj. Pa marrë parasysh të gjitha, këto pikëpamje të autorëve të njohur mund të thuhet se edhe personat e gjinisë femërore janë të kyçur në kryerjen e krimeve të ndryshme dhe se ato, këto krime i kryejnë nën ndikimin e rrethanave të caktuara shoqërore, ekonomike të cilat pak a shumë janë identike edhe për gjininë mashkullore.

Femra merr pjesë më pak në kryerjen e sjelljeve të ndryshme kriminale nga se ajo në të kaluarën ka qenë më pak e përfshirë në aktivitetet e ndryshme në shoqëri. Pra, pjesëmarrja më e vogël mund të kërkohej në pozitën e saj shoqërore, familjare, ekonomike, politike të cilën e ka pasur ose e ka sot në shoqëri. Dihet mirëfilli se femrat deri vonë, pra deri në shoqërinë bashkëkohore, nuk kanë qenë të kyçura në proceset e përgjithshme të jetës. Ato, më tepër, kanë qenë të preokupuara në lindjen, rritjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve dhe anëtarëve të familjes e më pak janë marrë me aktivitete dhe punë jashtë familjes, të cilat domosdo do t'i futnin në situata të ndryshme që do të sillnin deri të kriminaliteti i tyre.

Me emancipimin dhe kyçjen gjithnjë e më të madhe të femrës në të gjitha sferat e jetës dhe të punës, vërehet edhe shtimi dhe rritja e pjesëmarrjes së saj në aktivitetet kriminale. Kështu që, dukshëm vihen në pyetje disa konstatime të mëhershme teorike në kriminologji se gjoja kriminaliteti është dukuri tipike e meshkujve dhe se femrat për shkak të konstitucionit të tyre biofizik dhe biopsikik, objektivist, kryejnë më pak krime. Kontribut të veçantë në ndriçimin e pjesëmarrjes së femrave në kryerjen e krimeve të ndryshme ka dhënë autorja e njohur amerikane Freda Adler e cila i ka demantuar disa koncepte që ekzistonin më parë mbi shpjegimin e shkaqeve të krimit të femrave në teorinë dhe literaturën kriminologjike.

11. Gjendja martesore dhe statusi familjar

Në vazhden e vrojtimeve lidhur me disa karakteristika të kriminalitetit dhe kryerësve të tij, është me rëndësi të trajtohet edhe statusi familjar, përkatësisht gjendja martesore e tyre. Në bazë të shënimeve

të evidencave statistikore të vendeve të ndryshme, vërehet se numri më i i madh i kryerësve të krimeve, janë të martuar, në rend të dytë vijnë personat e pamartuar, personat e ndarë dhe të shkurorëzuar dhe në fund personat e ve. Pjesëmarrja e femrave të martuara, të ndara dhe të veja, është më e shprehur në kryerjen e krimeve të ndryshme se sa te meshkujt e së njëjtës gjendje martesore. Kategoria e kryerësve të pamartuar, më tepër paraqitet te gjinia mashkullore.¹⁰

Shkaku i krimit apo kriminalitetit mund të përkufizohet si ndryshim objektiv real i cili sjell deri te një dukuri tjetër reale, kurse e cila përsëri në rrjedhën e mëtejme të lëvizjes permanente në natyrë dhe shoqëri deri te ndryshimi i mëtejme dhe kështu gjithnjë deri në pafundësi. Ndërlikueshmëria e kriminalitetit të cilin e paraqitëm në mësimet e mëparshme përshkruan më së miri ndërlikueshmërinë e problemit me të cilin ballafaqohemi me rastin e shqyrtimit të shkaqeve të kriminalitetit. Studimin më kompleks për procesin e lindjes së kriminalitetit dhënë përmes sistemit të tij të etiologjisë kriminale.

12. Gjendja sociale ose statusi social

Në literaturën kriminologjike, një kohë të gjatë ka dominuar mendimi se kriminaliteti është karakteristik për shtresat e ulëta, sidomos për kategorinë e punëtorëve dhe njerëzve të papunë dhe të varfër. Këto konstatime janë bazuar në shënime mbi numrin e personave ndaj të cilëve janë bërë kallëzime penale, janë ngritur aktakuza ose janë shqiptuar dënime nga gjykatat. Vërehet se pjesëmarrja e punëtorëve dhe profesioneve tjera të shtresave të ulëta dhe të mesme të popullsisë në kryerjen e krimeve, është më e madhe në shumë vende të botës. Kjo kategori e popullsisë, veçmas merr pjesë në kryerjen e krimeve kundër pasurisë, kundër jetës dhe trupit dhe ne krime të tjera.

Mirëpo, në dekada e fundit, rritje të vazhdueshme tregon edhe krimi të cilin e kryejnë personat që u përkasin shtresave dhe klasave me të larta, qarqeve afariste dhe atyre në pushtet. Kësisoj, i ashtuquajturit kriminalitet i “jakës së bardhë” është vazhdimisht në rritje. Këtë rrethënë, veçmas e ka potencuar kriminologjia radikale, e cila flet për krimin

¹⁰ Autori i njohur Hans Gros, mendon se fenomenologjia kriminale duhet të merret me studimin e simptomave të jashtme të kriminalitetit. Mendimtari tjetër Ernest Selig, mendon se fenomenologjia kriminale nënkupton përshkrimin e formave speciale të kryerjes së krimeve të ndryshme, p.sh. teknikën e kryerjes së vjedhjeve me thyerje, mënyrën e falsifikimit, studimin e vetive dhe gjesteve të ndryshme të delikuentëve etj.

shumë të përhapur të qarqeve të pushtetit, i cili krim, fatkeqësisht nuk evidentohet dhe nuk luftohet.

Për praninë e këtyre krimeve, merret vesh vetëm herë pas here, kur shpërthejnë afera dhe konflikte brenda qarqeve të larta në pushtet, mirëpo edhe atëherë, segmentet e caktuara të pushtetit bëjnë përpjekje që këto krime të shuhen dhe rastet e tilla të mbyllen pa epilog gjyqësor.

Conclusion

Criminality as a negative phenomenon however has multiple roles. A controversial but very important standpoint, regarding the role of criminality in society, for the historical development of criminology, criminality remains an integral part of all societies, therefore, for this reason, the group that leads the society, certain forms of behavior defines as undesirable and as punishable. In every society, people are individuals, who because of their behavior can obtain the delinquent or criminal label.

A society that unifies behavior and does not allow individuality resembles to the expired society and the country where monotony prevails. Some authors have highlighted the most important roles of criminality in society stressing that criminality affects the establishment of a criterion for assessing good and bad society, so it is a big industry and unites different parts of the population, thus contributing to the effectiveness of social life and at the same time is a warning that in society there is something wrong and bad and warns that there is something wrong in society with social organization, even after all the set amount of criminal occurrences acts as a security valve. An important issue that criminologists are discussing is also the nature of the law and the definition of criminality. Laws are a formal expression of the system of values of the dominant social force of a certain culture, according to which, in the strict sense of the word, criminality most commonly means criminal offenses.

However, in the last decades, continuous growth also shows the crime committed by the persons belonging to the higher classes, business circles and those in power. Thus, so-called white collar criminality is constantly growing. This circumstance has specifically highlighted radical crime, which speaks of the widespread crime of power circles, which crime unfortunately is not evidenced and not fought by which phenomenon is currently facing Macedonia, the phenomenon that is

currently seeking a more advanced research and scientific approach to prevent it in our modern society.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Bashkim Dr.Selmani & Mevledin Dr.Mustafi “Sistemet e sigurisë-sisteme security”-Shtëpia Botuese Furkan ISM, Shkup, 2016
2. Rakip Dr. Halili, “Kriminologjia”, Prishtinë, 2000
3. Bashkim Dr. Bashkim Dr. Selmani, “Kriminologjia dhe penologjia”-Kolegji, Fama”-Prishtinë, 2013
4. Rakip Dr. Halili, “Penologjia”, Prishtinë 2000
5. Vasilika Dr. Hysi, “Kriminologjia”, Tiranë: Kristalina-KH 2005
6. J. Papandile dhe I. Mandro, “Kriminologji - Penologji”, Tiranë: Ilar 2002
7. Analiza juridike e konceptit të veprës penale të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, OSBE, Poliesterdej, Shkup, 2012
8. Rregullimi i mediave, studim komparativ, Dejvid Goldbert, Toni Proser dhe Stefan Berhulst, Ars Lamina, Shkup
9. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Stiven Grir, Prosvetno Dello, Shkup, 2009;
10. Liria e shprehjes dhe demokracia, Sllagjana Dimishkova, Veçer Press SHPK Shkup, Cetus print, Shkup, 2008
11. Freedom of the Media, Freedom of Expression, Free Flow of Information; Conference on Security and Co-operation in Europe (CSCE) and Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) 1975-2012, 2nd Edition.- Vienna: OSCE Representative on Freedom of the Media, 2013, 56 pp.
12. Manuali për të drejtën evropiane për mosdiskriminim, Agjencia për të Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian, Këshilli i Evropës, 2010
13. Hyrje në të drejtën evropiane, Desche Stiftung fur Internationale Rechtliche Zusammenarbeit E.V., Magor, SHPK, Shkup
14. Zbatimi i së Drejtës së Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë në periudhën para anëtarësimit në BE, Projekt Hulumtues Nacional Shkencor, Fakulteti i Drejtësisë, UCEM, BoroGrafika, Shkup
15. Gjuha e urrejtjes në mediat bullgare dhe maqedonase: shembuj, shkaqe, zgjidhje, Media development center
16. Analiza juridike e konceptit të veprës penale të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes OSBE, Poliesterdej, Shkup, 2012